



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
Kuvendi i Komunës
-Komiteti për Politikë dhe Financa-

01Nr. 06-350/02-22031/21
Kaçanik, 25.08.2021

Në bazë nenit 10.5 (b) të Ligjit nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, të nenit 3 lidhur me nenet, 6.3 dhe 7.1(b) të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, të Vendimit 01Nr.327/09 të Kuvendit të Komunës Kaçanik të datës: 30.01.2009, për Delegimin(Bartjen) e Kompetencës për ndërrimin e destinimit të sipërfaqeve të vogla të klasës së pestë(V-të) dhe të gjashtë(VI-të) të tokës bujqësore në atë ndërtimore në Komitetin për Politikë dhe Financa, të Propozim Vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06 Nr. 350/02 - 22031/21, Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 25.08.2021, mori këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE
NË TOKË NDËRTIMORE

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06-350/02-22031/21-Për Lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të **MUHAMET(HAKI) MALSIU** nga f. Rekë.
2. Toka e përcaktuar për ndërrimin e destinimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, Lejohet për sipërfaqen, **3591m²**, në parcelën kadastrale **P-70917083-00183-3**, Zona Kadastrale Soponicë, me kulturë bujqësore **Livadh i klasës 5(pestë)** me sipërfaqe **S=3591 m²**, pronë private në emër të Muhamet (Haki) Malsiu ,sipas Certifikatës Nr.86/2020 të lëshuar me datë 24.03.2020.
- 3.Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë: Propozim Vendimi i DUKMM , Aneks i Procesverbalit të komisionit për ndërrim destinim të tokës bujqësore , Çertifikata e pronës dhe kërkesa e palës për ndërrim destinim të pronës së bashku me disa dokumente shtesë.
- 4.Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores për hatimin dhe publikimin e akteve në komunë,ndërsa do të zbatohet pas pagesës së tarifave dhe ngarkesave administrative, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore të përcaktuara sipas Rregullores për taksa komunale.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizmat tjerë relevant), Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
06.Nr. 06-350/02-22031/21
Kaçanik, 20.08.2021

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Kaçanikut duke u bazuar në nenin 10.5 pika a të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokën Bujqësore; në bazë të nenit 6 pika 6.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësor, lidhur me kërkesën 06-350/02-22031/21 për ndërrim destinimi të tokës bujqësore:

Propozon

Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal, që lidhur me kërkesën e z.Muhamet Haki Malsiu nga fshati Rekë për ndërrim destinimi të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore, të merr:

VENDIM

Aprovohet kërkesa 06-350/02-22031/21 e datës 29.07.2021 e parashtruar nga z.Muhamet Malsiu për lejimin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore 3591 m², në parcelën kadastrale nr.P-70917083-00183-3, zona kadastrale Soponicë, me kulturë Bujqësore-livadh i klasës 5, me sipërfaqe 3591 m², pronë e Muhamet Malsiu.

Arsyetim


Në drejtorinë e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka arritur kërkesa me numër 06-350/02-22031/21 për ndërrimin e destinimit nga toka me kulturë bujqësore-livadh i klasës 5 në tokë ndërtimore.

Komisioni për shyrtimin e kërkesave për ndërrimin e destinimit ka rekomanduar DUKMM për lejimin e ndërrimit të destinimit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

Komisioni për ndërrim destinimi të tokës bujqësore

DATE:	20.08.2021
REFERENCE:	06Nr.350/02-22031/21
PËR:	Drejtorinë e DUKMM-së
CC:	
PËRMES:	
NGA:	Komisioni: 1. Mustafë Loku 2. Rakip Vishi 3. Arditë Shehu
TEMA:	Aneks i procesverbalit 06Nr.350/02-18807/21 të datës 22.07.2021 lidhur ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në ngastreh nr. 1001833

I përpiluar më datën 20.08.2021 lidhur me kërkesën Nr. 06Nr.350/02-22031/21 të datës 03.08.2021 të parashtruar këtij komisioni nga Drejtoria e DUKMM-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtimin e kërkesës 06Nr.350/02-18807/21 të datës 21.07.2021 paraqitur kësaj Drejtorie nga **z. Muhamet (Haki) Malsiu**, nga fshati Rekë, për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore pas ofrimit të dokumentacionit shtesë lidhur me qasjen në rrugë.

Lidhur me kërkesën komisioni ka konstatuar siç vijon:

Bazuar në dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i kërkesës në DUKMM për qasjen në rrugë, komisioni konstaton se parcela në fjalë ka qasje në rrugën magjistrale M2 Kaçanik – Ferizaj.

Ndërsa karakteristikat tjera janë të cekura në procesverbalin 06Nr.350/02-18807/21 të datës 22.07.2021.



REPUBLIKA E KOSOVES
RE PUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KACANIKUT
QIPSTINA KACANIK



Data	29.07.21	Vendi	Kacanik
Fig. orig.		Naturo	
		Shtet	

Për : Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mjedisit

Nga: Muhamet Malsiu

Tema: Plotësim dokumentacioni për kërkesën për ndërrim të destinimit të tokës.

Me qëllim të bërjes më të lehtë për vendosja në përgjigje të kërkesës sime ju njoftoj si në vijim:

Ndërrimi i destinimit të tokës është kërkuar me qëllimin e zhvillimit të biznesit të kombinuar i cili do të gjeneronte në vende të reja të punës në tre vjeçarim e ardhshëm:

1. Pikë karburante- 3 vende pune.
2. Minimarket- 4 vende pune.
3. Auto-servis- 3 vende pune
4. Auto-larje 3 vende pune.

Gjithsej do të krijoheshin 13 vende pune dhe me mundësi të zgjerimit në të ardhmen.

Arsyeja tjetër e ndërrimit të destinimit të tokës është se toka e ka humbur bonitetin për arsye të aktivitetit të trafikut, ndërtimit të rrethit të autostradës afër tokës sime, me çka edhe është dëmtuar edhe kualiteti i tokës nga kanali që është vendosur për rrjedhjen e ujërave që kullohen nga autostrada dhe magjistralja (e cila mund të konstatohet në vendin e ngjarjes), e që zhvillimi i biznesit do të krijonte mundësin e trajtimit me impiant të këtyre ujërave të ndotura, e që aktualisht ato derdhen pa kurrfarë trajtimi.

Gjithashtu mendoj se klasa tokës nuk është reale (klasa e 5te) pasi që është caktuar shumë kohë më parë, kur aty nuk ka ekzistuar asnjë veprimtari dhe para se rruga magjistrale ta ndante përgjysmë token time. me çka pjesa më e madhe është marr nga ministria e infrastrukturës.

Me këtë rast për plotësim të kërkesës së mëparshme po i bashkëngjisë edhe dokumente si në vijim:

1. Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës,
2. kërkesën e bërë për pagesa në Departamentin e Shpronësimit,
3. dhe ortofotet e vitit 2018 si ka qenë gjendja e mëparshme.

Duke shpresuar në një reagim të shpejt dhe pozitiv nga ana juaj, ju përshëndes paraprakisht!

Me respekt.

Muhamet Malsiu, nr: letërnjoftimit : 1005973569,

Mobil: +383 45 998 899; e-mail: mmalsiu@gmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRATVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVO / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917083-00183-3

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:
Data dhe koha e fshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:
Komuna / Opština / Municipality:
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone:
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: Kaçanik / Kačanik / Kačanik

36/2020

24.03.2020 - 09:23

Kaçanik / Kačanik / Kačanik

SOPONICË / SOPOTNICA / SOPOTI

Kaçanik / Kačanik / Kačanik

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70917083-00183-3	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	3591		10.03.2020	10.03.2020

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivaliste - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adresa Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ÇARDAK / ÇARDAK / ÇARDAK		ÇARDAK	10.03.2020	10.03.2020

A2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shtyrëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Bujqësori/Poljoprivredno/Agriculture	Livadh/Livade/meadow	Livadh I Klasës 5/Livada 5 Klase/5th Class Meadow	3591

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	MALSIU MUHAMET (HAKI)	1005973569	REKË / REKA / MALËSIA /			1/1	86/2020 Aktigjykim i Gjykatës Supreme AC-I-18-0158-A0001	24.03.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG
PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

Komuna: Kaçanik
Zyre: Zyra kadastrale komunale
Zona Kadastrale: SOPONICË

Numri referent i lëndës: 86/2020

Në mbështetje të Nenit 3 të Ligjit Nr. 2002/5 mbi Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr. 2003/13 dhe neni 4 i Ligjit Nr. 04/L-009, në bazë të kërkesës së Muhamet (Haki) Malsiu me vendbanim në Ferizaj, me numër personal 1005973569, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET – Pjesërisht kërkesa e parashtruar nga Muhamet (Haki) Malsiu me vendbanim në Ferizaj, me numër personal 1005973569, e cila ka të bëjë me Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit, sipas aktit juridik Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës AC-I-18-0158-A0001 të datës 12.12.2019, ku në bazë të Aktgjykimit ju është njohur e drejta e pronësisë Haki (Sali) Malsiu ish nga Fsh.Rekë-Kaçanik lidhur me njësin kadastrale nr.00183-1 me sip.prej 00.64.50 ha,ZK.Soponicë, mirpo pas Egzekutimit të elaboratit të shpronësimit parcela në fjalë është ndarë në dy parcela .
Njësin kadastrale nr.00183-3 me sip.prej 00.35.91 ha,ZK.Soponicë, e cila paluajtshmëri evidentohet në emër të NSH Koperativa Shtërpoc ndërsa regjistrohen në RDPP në emër të trashëgimtarit të Haki (Sali) Malsiu , Muhamet (Haki) Malsiu me vendbanim në Ferizaj, me numër personal 1005973569.

Arsyetim

Zyra Kadastrale Komunale Kaçanik ka pranuar kërkesën e parashtruar nga Muhamet (Haki) Malsiu me vendbanim në Ferizaj, me numër personal 1005973569, për regjistrimin e të drejtave në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme dhe kërkesës së tij-saj ia ka bashkangjitur dëshmitë e plota për regjistrim (lloji i dokumentit):
Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës AC-I.-18-0158-A0001 të datës 12.12.2019,Vendimi nr.protokollit nr.166/2020,Çertifikatet e pronësisë,Vërtetimi i tatimit në pronë,letërnjofti fotokopje dhe taksa e paguar.

Sipas gjendjes së konstatuar janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrim sipas dispozitave të cekura më lart.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur ka të drejtë që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të kërkojë nga ZKK rishqyrtimin e tij.

Aktvendimi i dorëzohet:
Arkiv,
Shërbimit përkatës,
Parashtruesit të kërkesës


Zyrtari përgjegjës
Ilir Krivenjeva

Data: 12.03.2020

Drejtori
Ukshin Qallaku

Harta Kadastreale

me ortofoto të vitit 2018 dhe pozita e parc.kad.nr.183-1 z.kad.Soponicë.




DEPARTAMENTI I SHPRONESIMIT –MMPH

KERKESE

Kërkoj nga Departamenti i Shpronësimit të me jap Raportin e Vlerësimit të Pronës fotokopje
për ngastrat kadastrale nr. 183-1 Zona Kadastrale SOPONICE

Komuna KAFANIK meqë nuk me kanë ardhur
përmes postës në kohën

kur i ka dorëzuar Departamenti i Shpronësimit.



Prishtine

Date: 01.06.2020

Paraqitësi i Kërkesës (Emri dhe Mbiemri)

Muhamet Nalini

Nalini
Nënshkrimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
Ministarstvo Infrastrukture i Sredine-Ministry of Infrastructure and Environment
Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

Sipas: Ligjit Nr.03/L-139
PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME
Me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010

Neni 16
Pagesa e kompensimit

6. Shuma e kompensimit të shpronësimit e përcaktuar në Vendimin Përfundimtar paguhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

Koment:

Pala për të realizuar këtë të drejtë të cekur më lartë, duhet të aplikojë për kompensim pranë Departamentit për Shpronësim, me dokumentacionin përkatës të paraqitur më poshtë:

Dokumentacioni	Dorëzoi	
Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme - origjinale (jo më të vjetra se 6 muaj)	Po	Jo
Kopja e Letërnjoftimit	Po	Jo
Kopja e kartelës së bankës (jo e pensioneve)	Po	Jo
Akti i Vlerësimit <i>Kopje me DEN</i>	Po	Jo
Vendimi i Gjykatës/Noterit mbi trashëgiminë nëse pronari i pronës ka vdekur ose është shpallur i zhdukur - origjinali	Po	Jo
Autorizimi (nëse është e nevojshme) i vulosur në Gjykatën Themelore/Noteri - origjinali	Po	Jo
Nëse prona është nën Hipotekë në ndonjërin nga bankat komerciale, Vërtetimi nga Banka përkatëse që dëshmon se prona e paluajtshme është liruar nga hipoteka.	Po	Jo
Të tjera	Po	Jo

Dorëzoi: *[Signature]*

Pranoi: *[Signature]*

Date: 01.06.2020

Departamenti i Shpronësimit/Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

Sipas: Ligji Nr.03/L-139

PËR SHPRONËSIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME

Me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010

Neni 16

Pagesa e kompensimit

6. Shuma e kompensimit të shpronësimit e përcaktuar në Vendimin Përfundimtarë paguhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit. Nëse kompensimi nuk paguhet brenda kësaj kohe, Personi i cili është dashur të pranojë kompensimin mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për të kërkuar nxjerrjen e një urdhri për revokimin ose anulimin e këtij vendimi.

Për realizimin e kompensimit është i nevojshëm dokumentacioni si në vijim:

Dokumentacioni	Dorëzoi	
Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme - origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj)	Po	Jo
Kopja e letërnjoftimit	Po	Jo
Konfirmimi i numrit të xhirologarisë bankare - origjinal (jo i pensioneve)	Po	Jo
Raporti i vlerësimit - origjinal	Po	Jo
Akti i vdekjes (nëse pronari është i vdekur) - origjinali	Po	Jo
Vendimi i Gjykatës/Noterit mbi trashëgiminë nëse pronari i pronës ka vdekur ose është shpallur i zhdukur - origjinali	Po	Jo
Autorizimi i noterizuar - origjinali	Po	Jo
Nëse prona është nën hipotekë në ndonjërin nga bankat komerciale, vërtetimi nga banka përkatëse që dëshmon se prona e paluajtshme është liruar nga hipoteka - origjinal.	Po	Jo
Të tjera	Po	Jo

Dorëzoi:

Franoi:

Datë:

Vërejtje: Për çdo paqartësi apo plotësim të dokumentacionit pala do të kontaktohet.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/38
 Datë: 29.03.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, me nr. prot. 1383, datë 16.03.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M P E R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Zonat Kadastrale Doganaj, Soponicë, Rekë, Nikaj, Biqec, Koxhaj, Gajre, Gjurgjedell, Kaçanik, Kaçanik i Vjetër, Kovaqec të Komunës së Kaçanikut, Zonat Kadastrale Paldenicë dhe Pustenik Komuna Hani i Elezit dhe Zona Kadastrale Mirash, Komuna e Ferizajit, sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresat përcjellëse të Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 1985/17 datë 14.04.2017, 6376/17 datë 04.12.2017, dhe 1137/18 datë 27.02.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/115

Datë: 09.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës me nr. protokolli 935/3 të datës 30.09.2016, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat janë të nevojshme për realizimin e Projektit me interes publik - ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë - Han i Elezit, Sektorët C2C dhe C3, Zonat Kadastrale: Kaçanik i Vjetër, Koxhaj, Soponicë, Doganaj, Rekë, Nikaj, Biqec, Kovaçec, Bob, Gajre, Kaçanik dhe Gjurgjedell të Komunës së Kaçanikut, sipas tabelave të janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelës së vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" me nr. protokolli 4165/16 datë 21.09.2016.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bën shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkuar, cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

43	Nika Bekim (Isma) 1/2 Nika Bajram (Isma) 1/2 nga Kaçaniku	223-1	mal-1	17169	7200	9969
44	Dogani Xhelal (Ramush) nga Soponica	223-3	mal-1	11762	8936	2826
45	Nika Bekim (Isma) 1/2 Nika Bajram (Isma) 1/2 nga Kaçaniku	224-0	are-6	4356	551	3805
46	Tusha Nexhibe (e veja e Sadriut) nga Soponica	508-1	mal-3	1171	1171	0
47	Tusha Sadik (Rifat) nga Soponica	508-5	mal-3	1171	1171	0
48	P.SH Kuvendi i Komunes Kaçanik	509-0	varreza	4779	2014	2765
49	P.SH Kuvendi i Komunes Kaçanik	511-0	varreza	1453	1243	210
50	Maisiu Reshat (Limen) nga Reka	513-1	are-2	1845	500	1345
51	Baftijaj Hilmi (Osman) nga Vataj-Dubravë	534-0	livadh-2	1804	245	1559
52	Baftiu Muharrem (Halim) nga Vataj-Dubravë	535-0	livadh-2	411	411	0
53	Baftijaj Avdi (Ramadan) nga Vataj-Dubravë	537-3	livadh-2	472	472	0
54	Baftijaj Avdi (Ramadan) nga Vataj-Dubravë	537-2	jopjellore	6185	2039	4146
55	P.SH..Koperativa Shtërpce	180-2	livadh-5	1869	365	1504
56	P.SH..Koperativa Shtërpce	181-1	livadh-5	6586	65	6520
57	P.SH..Koperativa Shtërpce	182-2	livadh-5	3317	187	3130
58	P.SH..Koperativa Shtërpce	183-1	livadh-5	3776	171	3605
59	P.SH..Koperativa Shtërpce	184-1	livadh-5	4388	157	4231
60	P.SH..Koperativa Shtërpce	204-1	livadh-5	2507	335	2172
61	Tusha Zeqir (Shukri) nga Soponica	541-0	arë-2	1576	1116	460
62	Tusha Manush (Islam) nga Soponica	542-0	arë-2	1401	1401	0
63	Tusha Hazbije (e veja e Shabiut) nga Soponica	543-1	arë-2	3122	2222	900
64	Tusha Murtez (Isman) nga Soponica	544-0	arë-2	2005	208	1798
65	Tusha Bajram (Bafli) nga Soponica	675-0	arë-2	2561	2146	415
66	Tusha Bajram (Bafli) nga Soponica	676-0	arë-2	2010	448	1562
67	Dallosi Muharrem (Sulejman) nga Soponica	678-0	tokë tjetër	2148	643	1505
68	Mema Imer Dervish nga Vataj-Dubravë	682-1	tokë tjetër	807	55	752
69	Mema Imer Dervish nga Vataj-Dubravë	682-2	jopjellore	1841	247	1694
70	Topalli Selman (Rexhep) nga Soponica	683-0	jopjellore	2498	2155	343
71	Mema Sylejman (Sinan) nga Vataj-Dubravë	686-2	jopjellore	1606	97	1509
72	Topalli Rrahim (Xhemal) nga Soponica	680-0	tokë tjetër	700	700	0
73	Topalli Hatixhe (Tahir) 1/10 Topalli Ramiz (Tahir) 1/10 Topalli Rabishe (e veja e Tahirut) 1/10 Topalli Avdyli (Tahir) 1/10 Topalli Haxhere (Tahir) 1/10 Vishi Hazbije (e lin.Topalli gr.e Nuhut) 1/10 Topalli Zyrtije (e veja e Tahirut) 4/10 nga Soponica	681-1	livadh-1	2797	2797	0
74	Topalli Hatixhe (Tahir) 1/10 Topalli Ramiz (Tahir) 1/10 Topalli Rabishe (e veja e Tahirut) 1/10 Topalli Avdyli (Tahir) 1/10 Topalli Haxhere (Tahir) 1/10 Vishi Hazbije (e lin.Topalli gr.e Nuhut) 1/10 Topalli Zyrtije (e veja e Tahirut) 4/10 nga Soponica	681-2	jopjellore	300	300	0



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
 VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

AC-I.-18-0158-A0001

Në çështjen juridike të:

Haki (Sali) Malsiu nga Fshati Rekë - Kaçanik, i përfaqësuar nga avokati Daut Rudi- Kaçanik.

Paditësi/ankuesi

Kundër

NSH Kooperativa Shtërpç.

Agjencisë Kosovare të Privatizimit(AKP), Rruga "Agim Ramadani", 23 Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami gjyqtar kryesues, Sabri Halili, dhe Mr.sc.Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-III.-14-0187-C0001, të datës 22 shkurt 2018, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 dhjetor 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit është e bazuar.
2. Ndryshohet pika 2 e Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-III.-14-0187-C0001, i datës 22 shkurt 2018 dhe paditësit i njihet e drejta e pronësisë lidhur me ngastrën kadastrale nr. 183/1 me një sipërfaqe prej 00.64.50 ha në zonën e quajtur "Çardak", Zona Kadastrale e Soponicës- Komuna e Kaçanikut.



3. Anulohet pika 1 e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe lidhur me këtë pikë lënda dërgohet në rigjykim.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 23 korrik 2014, paditësi parashtroi padi në DHPGJS-në në cilësinë e trashëgimtarit të të ndjerit Haki Malsiu i cili kërkoj konfirmimin e pronësisë së tokës me sipërfaqe të përgjithshme prej 01.24.50 ha të specifikuar si më poshtë: -parcela kadastrale nr. 179 me sipërfaqe prej 00.60.00 ha dhe parcela kadastrale nr. 183 me një sipërfaqe prej 00.64.50 ha. Këto parcela (prona e kontestuar) janë të vendosura në një zonë të quajtur "Çardak", Zona Kadastrale e Soponicës në Komunën e Kaçanikut.

Paditësi ka paraqitur dëshmi në mbështetje të padisë:- Kopjen e kontratës të datës 19 tetor 1962 të lidhur në mes të Kooperativës Bujqësore "Ramadan Agushi" Kooperativa Bujqësore Eksporti dhe Komunës së Kaçanikut, - Një kopje të vendimit të Këshillit Popullor të Komunës së Kaçanikut nr. 992, të datës 25 prill 1962, -Kopjen e vendimit të lëshuar nga Komuna e Kaçanikut, me datë 11 nëntor 1963, - Kopjen e procesverbalit lëshuar nga komisioni me datë 08 gusht 1970, -Kopjen e Vendimit të revizionit nr. 2436/67 të datës 15 tetor 1971, -Kopjen e padisë së paraqitur në Gjykatën Komunale të Ferizajt me datë 12 tetor 1972, Një dokument të datës 26 shtator 2006, lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi në Kaçanik (në fuqi deri në fund të vitit 1966) me titull Lista e Posedimit që përmend pronën kontestuese në emër të Haki Sali Malsiut -Një kopje të planit për pronën kontestuese të datës 26 shtator 2006 -Një kopje të njoftimit për qëllimin e paraqitjes së padisë, të parashtruar nga paditësit në AKP me datë 02 prill 2014 -Vendimi mbi trashëgimin me nr .LRP. nr. 2406/2017 nr ref 814/2017 lëshuar nga noteri Hebib Livoreka nga Kaçaniku, që konfirmon se Muhamet Malsiu është i vetmi trashëgimtar i të ndjerit Haki Malsiu.

Më datë 22 janar 2016 AKP parashtroi mbrojtje në padi duke i kundërshtuar pretendimet e paditësit si të pa bazuar në ligj. Në mbrojtje theksohet paditësit nuk e mbështeten pretendimin e tyre me prova të duhura. Referencë i është bërë nenit 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit mbi DHPGJS-në dhe nenit 253 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Paditësi dështoi gjithashtu për të përmendur bazat ligjore që i mbështesin pretendimet e tij. AKP konsideron se Kooperativa Bujqësore është pronar legjitim i pronës së kërkuar nga paditësi, prandaj i propezon-Gjykatës ta refuzojë padinë si të pabazuar. AKP si dëshmi bazë në mbështetje të mbrojtjes së saj ka

paraqitur: Ortofotot e pronës kontestuese, Kontratën e privatizimit të këtyre parcelave kadastrale (NK 179 dhe NK 183/2), Certifikatën e pasurisë së paluajtshme, Dokumentet të cilat dëshmojnë se NK 183 është ndarë NK 183/1 dhe NK 183/2.

Më 22 shkurt 2013 Kolegji i Specializuar kishte marrë Aktgjykim C-III-14-0187-00001, me të cilën padia lidhur me parcelën kadastrale 179 ishte refuzuar për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv, ndërsa padia lidhur me parcelën kadastrale nr. 183, refuzohet si e pabazuar. Arsyetimi ligjor i këtij aktgjykimi bazohet në faktin se ekziston mungesa e legjitimitetit pasiv e të paditurës për ngastrën nr.179, e cila bazohet në dokumentin e paraqitur nga AKP-ja e cila tregon se kjo ngastër, ishte privatizuar më 28 mars 2012, dhe e njëjta nuk është në posedim ose në pronësi të paditurës.

Sa i përket kërkesës lidhur me parcelën kadastrale nr.183, sipas dëshmive të paraqitura nga AKP-ja (të dhënat kadastrale dhe kontratat për transferimin e pronës së Paluajtshme) mund të shihet se ngastra kadastrale nr.183 në evidencat kadastrale nuk ekziston si e tillë. Parcela kadastrale kontestuese ishte ndarë në dy pjesë, nr. 183/1 dhe 183/2. Për më tepër parcela kadastrale 183/2, sipas kontratës së dhënë për transferimin e pronës, e datës 28 mars 2012 ishte tjetërsuar në valën e 53 të privatizimit. Andaj për të gjitha arsyet e lartpërmendura kërkesa lidhur me ngastrën kadastrale nr.183 duhet të refuzohet si e pabazuar.

Më 13 mars 2018, paditësi(ankuesi) kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi për shkak të të gjitha arsyeve ankimore. Ankuesi pretendon se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe se dispozitivi është në kundërtënie me arsyetimin, por, sipas ankuesit, arsyetimi nuk përmban arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike.

Konstatimi jo i plotë i gjendjes faktike, sipas ankuesit, konsiston në faktin se gjykata nuk i ka shqyrtuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjitha provat e prezantuara, por ekskluzivisht ka vendosur sipas pretendimeve të AKP-së. Konstatimi i Kolegjit të Specializuar se lidhur me ngastrën nr. 179 mungon legjitimiteti pasiv i AKP-së, sepse ajo ngastër tashmë është shitur, sipas ankuesit është i paqëndrueshëm, duke përmendur disa arsye për këtë pretendim. Një arsye ankuesi e përmend faktin se për refuzimin e padisë lidhur me këtë ngastër gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 78 të LPK-së, ngase në momentin kur gjykata kupton se i mungon palës legjitimiteti pasiv, është dashur që të veprojë konform kësaj dispozite, e jo me aktgjykim ta refuzoj padinë për shkak të legjitimitetit pasiv.



Sa i përket refuzimit të padisë lidhur me ngastrën nr. 183 me arsyetimin se kjo ngastër ishte privatizuar në valën e 53, edhe këtë konstatim të gjykatës ankuesi e konsideron të paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ankuesi konsideron se nuk është identifikuar qartë parcela kontestuese dhe se ai ka kërkuar nga gjykata që të caktoj ekspertin dhe të dilet në vendin e ngjarjes, por gjykata nuk e ka pranuar këtë propozim dhe ka vendosur vetëm sipas thënieve të AKP-së. Ankuesi duke u bazuar në këto argumente propozon që ankesa të aprovohet, të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Më 19 korrik 2018 AKP parashtroi përgjigje në ankesë e cila në tërësi e kundërshtoi ankesën e paditësit, duke e konsideruar si të pa bazuar në ligj. AKP konsideron se as me ankesën e paraqitur kundër këtij aktgjykimi, paditësi nuk ka arritur të paraqesë ndonjë bazë juridike të besueshme, dhe as nuk ka mundur të konstatojë një gjendje tjetër faktike prej asaj si e ka vërtetuar Kolegji i Specializuar me këtë aktgjykim.

Më 16 korrik 2019 Kolegji i Apelit ka kërkuar nga AKP që të dëshmoj me prova shitjen e këtyre ngastrave kontestuese të konstatuar nga Kolegji i Specializuar me aktgjykimin e kundërshtuar. Në përgjigjen e saj AKP edhe një herë ka konfirmuar se këto prona tashmë janë shitur në valën e 53 me privatizim dhe ka bashkangjitur edhe kontratat e shitblerjes.

Në përgjigjen e saj AKP konfirmon dhe dëshmon se parcelat nr.179 dhe nr. 183/2 tashmë janë bartur tek personat e tretë, ndërsa ngastra nr. 183/1 me sipërfaqe prej 3776m² ende nuk është shitur dhe është në emër të NSH-së të cilën e menaxhon AKP. Sipas dëshmive në dosje të lëndës, ngastra nr. 183 ishte ndarë në dy ngastra nr. 183/1 dhe 183/2.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Specializuar me aktgjykimin e ankimuar e kishte refuzuar kërkesëpadinë për të dyja parcelat e pretenduara. Lidhur me parcelën kadastrale 179 padia ishte refuzuar për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv, ndërsa padinë lidhur me parcelën kadastrale nr. 183(e ndarë si ngastra 183/1 dhe 183/2), për shkak se ishte e pabazuar. Kolegji i Specializuar kishte




konstatuar se tashmë parcela nr. 183/2 dhe 179, ishin shitur nga AKP-ja në valën e 53 me privatizim.

Ankuesi e kundërshtoi konstatimin e Kolegjit të Specializuar, se lidhur me ngastrën nr. 179 mungon legjitimiteti pasiv i AKP-së, për shkak se ajo ngastër tashmë është shitur. Sipas ankuesit, në këtë rast gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 78 të LPK-së, ngase në momentin kur gjykata kupton se i mungon palës legjitimiteti pasiv, është dashur që të veprojë konform kësaj dispozite, e jo me aktgjykim ta refuzojë padinë për shkak të legjitimitetit pasiv.

Kolegji i Apelit e mbështetë këtë pretendim ankimor të paditësit plotësisht, pasi që është e qartë se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, nuk i ka dhënë rast paditësit ta ndryshojë padinë për ngastrat e shitura, të cilat nuk mund të kthehen më, dhe të kërkojë kompensim monetar.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të Vendimit të revizionit nr. 2436/67 të datës 15 tetor 1971 dhe Kopjes së një dokumenti të datës 26 shtator 2006, lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi në Kaçanik (në fuqi deri në fund të vitit 1966) me titull Lista e Posedimit, paditësi e kishte titullin pronësor, pasi që në bazë të këtyre provave shihet se prona kontestuese ishte në emër të paraardhësit Haki Sali Malsiut. Sipas këtij vendimi, ishte anuluar vendimi i Komisionit të Këshillit Popullor Komunal me të cilin Haki Malsiu ishte shpallur uzurpator i kësaj prone. Ndaj Vendimit të revizionit nr. 2436/67 të datës 15 tetor 1971, nuk është ngritur asnjë mjet i goditjes, andaj ai ka marrë formën e prerë. Ky vendim tashmë siç u tha, e ka vlerën e titullit ekzekutiv, andaj Kolegji i Apelit e ndryshon pikën 2 të Aktgjyimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-III.-14-0187-C0001, të datës 22 shkurt 2018, dhe paditësit i njihet e drejta e pronësisë lidhur me ngastrën kadastrale nr. 183/1, me një sipërfaqe prej 00:64/50 ha në zonën e quajtur "Çardak", Zona Kadastrale e Soponicës-Komuna e Kaçanikut, pasi që kjo pronë ende nuk është shitur dhe është në emër të NSH-së, të cilin fakt e konfirmon edhe AKP-ja.

Sa i përket ngastrës kadastrale nr. 179, Kolegji i Specializuar pa të drejtë e kishte refuzuar padinë për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv. Lidhur me këtë kërkesë nuk mund të thuhet se AKP nuk ka legjitimitet pasiv, për shkak se ajo me veprimin e saj konkret e ka tjetërsuar një pronë për të cilën paditësi e ka një titull ekzekutiv. Megjithatë kjo ngastër tashmë është shitur nga AKP, konform nenit 10 paragrafi 3.2 të LDHPGJSK-së nr.06/L-086, në këto raste paditësi ka të drejtë të kompensimit adekuat monetar për humbjen e kësaj të drejte. Për këto arsye Kolegji i Apelit e anulon pikën 1 të dispozitivit të aktgjyimit të ankimuar me të cilin ishte refuzuar padia lidhur me ngastrën kadastrale nr. 179 dhe lidhur me këtë ngastër lënda dërgohet në rigjykim në kolegjin e shkallës së parë të DHPGJSK-së, për t'i dhënë mundësi




URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT

Kërkojmë nga ju të dërgoni këtë aktvendim aktgjykim tek:

- Palët
- Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në lëndën me numër C-III-14-0187.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO
	DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA SPECIAL CHAMBER OF SUPREME COURT
	VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUNDISHËM ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA DECISION IS FINAL
	Data / Datum <u>12.12.2019</u>
	Regjistruesi / Registrator 

palës ta ndryshon padinë dhe në vend të kësaj ngastre e cila më nuk mund të kthehet, ai mund të kërkoj një kompensim monetar.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Meqenëse ankuesi tashmë ka paguar 100 euro në emër të taksës gjyqësore, sipas kërkesës së Zyrës së Regjistrimit të DHPGJSK-së, për parashtrimin e ankesës, nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 12 dhjetor 2019.

Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues

